



BASHKIA MIRDITË

Buletini i Muajit Nëntor 2025

Delegacioni i Kongresit të Autoriteteve Vendore vizitë monitorimi në Bashkinë Mirditë

Më datë 18 Nëntor 2025, Delegacioni i Kongresit të Autoriteteve Vendore të Këshillit të Evropës zhvilloi një vizitë monitorimi në Bashkinë Mirditë, në kuadër të procesit të vlerësimit të zbatimit të angazhimeve të vendeve anëtare ndaj Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore.

Delegacioni u drejtua nga Z. Anders Knape (Suedia) dhe Z. Sören Schumacher (Gjermania), të shoqëruar nga përfaqësuesja e Sekretariatit të Kongresit, znj. Svitlana Pereverten, si dhe Prof. Zoltán Szente, ekspert i pavarur i Kartës së Vetëqeverisjes Vendore.

Gjatë takimit me Kryetarin e Bashkisë Mirditë, Z. Albert Melyshi, u diskutuan çështje kyçe që lidhen me funksionimin e pushtetit vendor, përfshirë:

- autonominë e njësisë të vetëqeverisjes vendore,
- çështjet e decentralizimit financiar,
- ndërhyrjet në kompetencat e bashkive,
- sfidat në funksionimin efektiv të institucioneve vendore.

Kryetari i Bashkisë Mirditë paraqiti shqetësimet kryesore të bashkisë duke theksuar nevojën për rritjen e mbështetjes nga niveli qendror dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim garantimin e një funksionimi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes vendore.

Pas përfundimit të të gjitha vizitave monitoruese në Shqipëri, do të përgatitet një Raport dhe një Rekomandim zyrtar për Shqipërinë, të cilat do t'i paraqiten për shqyrtim dhe miratim Kongresit të Autoriteteve Vendore të Këshillit të Evropës në sesionet e radhës.



Demo Day – TIP Mirdita 2025

Më datë 3 nëntor 2025, u zhvillua konkursi i prezantimit të ideve (Demo Day) nga aplikantët e Programit Mbështetës për të Rinjtë e Bashkisë Mirditë – TIP Mirdita 2025.

Aktiviteti u organizua nga Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me ekspertët e GIZ, si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për të nxitur inovacionin, sipërmarrjen rinore dhe zhvillimin e start-up-eve lokale në fushat e turizmit, blegtorisë dhe bujqësisë.

Demo Day i TIP Mirdita 2025 solli bashkë energjinë, kreativitetin dhe vizionin e ndërmarrësve lokalë, duke dëshmuar potencialin e Mirditës për zhvillim të qëndrueshëm rural dhe ekonomik.

Urime të përzemërta 13 fituesve që do të marrin mbështetje nga Bashkia Mirditë për të zhvilluar më tej idetë e tyre



Një aktivitet i veçantë u zhvillua në Bashkinë Mirditë, duke bashkuar artistët e vegjël – instrumentistët, valltarët, këngëtarët – mësuesit e tyre, si dhe brezat e kaluar të QKF-së.

Fëmijët e artistët e vegjël janë ata që gjallërojnë çdo rast feste dhe gëzimi në Mirditë, duke na bërë të gjithëve krenar për talentin dhe energjinë e tyre.

Në shenjë vlerësimi për përkushtimin e tyre ndaj mësimdhënies dhe vazhdimësisë së trashëgëmisë sonë artistike, kryetari i Bashkisë Mirditë ndau certifikata mirënjohjeje për:

Z. Kol Picaku, Z. Fran Gjergji, Z. Ilirjan Simoni dhe Z. Angjelo Gjoka, si dhe për të gjithë artistët pjesëmarrës.

Aktiviteti u mbyll me një performancë të fëmijëve në çifteli duke shfaqur pasionin për muzikën tonë tradicionale.



Programi i Punëve Publike në Komunitet

Programi i punëve publike në komunitet po zbatohet për të dytin vit radhazi nga Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, dega Mirditë.

Ky program është shndërruar tashmë në një mundësi konkrete punësimi dhe integrimi për punëkërkuesit afatgjatë.

Gjatë takimit të zhvilluar me Kryetarin e Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, Drejtorin Rajonal të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Lezhë, z. Agostin Marku, si dhe Përgjegjës të Zyrës Vendore të Punësimit Mirditë, z. Dritan Pepkolaj, u prezantuan 12 pjesëmarrësit e rinj të programit.

Ata do të angazhohen me kohë të pjesshme në shërbimet publike të bashkisë dhe njëkohësisht do të përfitojnë trajnime që synojnë rritjen e kompetencave të tyre individuale dhe profesionale.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak

Më datë 26 nëntor 2025 u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Mirditë, gjatë së cilës u miratuan këto projekt-vendime:

1. P/Vendim nr. 5560/1 prot; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, për periudhën 01 - 31 Tetor 2025”, Bashkia Mirditë .
2. P/Vendim nr. 5876/1 prot; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondine bashkisë, për periudhën 01 – 31 Tetor 2025”, Bashkia Mirditë.
3. P/Vendim nr. 5868/1 prot; “Për miratimin e Paketës Fiskale Vendore për vitin 2026 ” , Bashkia Mirditë.
4. P/Vendim nr. 5878/1; “Për miratimin e Planit të Aktiviteteve, Buxhetit dhe Konsultimeve të Këshillit Bashkiak Mirditë, për vitin 2026”.



Gërmime arkeologjike në Mirditë

Gjatë muajit nëntor u zhvilluan gërmime arkeologjike në Kthellën e Epërme, Mirditë, të kryera nga arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore), me mbështetjen e Bashkisë Mirditë.

Të dhënat e deritanishme arkeologjike nga kjo zonë paraqiten tepër interesante dhe shoqërohen me një toponimi të pasur e domethënës, e cila dëshmon për një aktivitet të vazhdueshëm njerëzor që prej Periudhës së Hekurit të Hershëm e deri në Antikitetin e Vonë.

Hulumtimet dhe gjurmimet arkeologjike do të vijojnë edhe në fazat e ardhshme, ku priten rezultate të rëndësishme për njohjen dhe zbulimin e mëtejshëm të thesareve të trashëgimisë kulturore të Mirditës dhe më gjerë.



“Muzeu im”, një nismë që lidh brezat përmes trashëgimisë kulturore



Nxënësit e shkollave "Gjimnazi Rrëshen", shkollat 9-vjeçare "Pashko Vasa" dhe "Nënë Tereza" u bënë “kuratorë” të kujtesës sonë kulturore përmes aktivitetit “Muzeu im”, një iniciativë e Muzeut Historik Kombëtar dhe shoqatës "Qoshe Kulture".

Rreth 100 fëmijë nga qyteti i Rrëshenit, sollën objekte me vlerë historike apo emocionale nga familjet e tyre. Secili prej tyre ndau historinë që shoqëron objektin.

Kështu, në vend që të shohin historinë vetëm në vitrinat muzeore të një muzeu, ata e ndjenë atë përmes rrëfimeve vetjake, duke kuptuar se trashëgimia nuk është vetëm e kaluar, por një pjesë e gjallë e identitetit tonë.

Aktiviteti “Muzeu im” synon të ndërgjegjësojë të rinjtë për rëndësinë e ruajtjes së objekteve kulturore dhe forcimin e lidhjes ndërmjet brezave përmes kujtimeve e përvojave që na bashkojnë.

Një falënderim i veçantë për mësuesit dhe nxënësit që mbështetën me pasion këtë nismë.



Ekspozita “Thesare shqiptare nëpër botë” në Mirditë

Muzeu Historik Kombëtar solli në Mirditë ekspozitën “Thesare shqiptare nëpër botë”, duke prezantuar objekte të trashëgimisë sonë kulturore që ruhen në muze të njohur ndërkombëtarisht, nga Londra dhe Vjena, te Stambolli, Nju Jorku dhe Toronto.

Në ekspozitë u prezantuan edhe dy objekte me origjinë nga Mirdita, pjesë e koleksionit të British Museum: Xhupi i Mirditës dhe Djepi.

Këto artefakte dëshmojnë lidhjet historike të Mirditës me trashëgiminë kombëtare dhe përhapjen e gjurmëve shqiptare në botë.



Qendra burimore lëvizëse në Mirditë

Në Mirditë u zhvillua një aktivitet i organizuar nga Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, në kuadër të aktivitetit “Qendra Burimore Lëvizëse” – një tur informues dhe nxitës që synon të rrisë pjesëmarrjen qytetare në hapësirën publike, si dhe të afrojë burime dhe ekspertizë pranë aktorëve lokalë.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të rinj aktivistë, nxënës, anëtarë të Këshillit Vendor Rinor, përfaqësues të Bashkisë Mirditë dhe staf akademik lokal.

Takimi ofroi një hapësirë dialogu dhe shkëmbimi përvojash, ku u diskutua mbi angazhimin e komunitetit, përfshirjen e të rinjve dhe rolin e aktorëve lokalë në proceset e integritimit evropian, si dhe mbi sfidat që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve.

